



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.417/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partija Kosovskih Srba (PKS), me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa A.nr.417/2025, e datës 07.02.2025 e parashtruar nga Partija Kosovskih Srba (PKS), me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.417/2025, nga Partija Kosovskih Srba (PKS), me seli në Mitrovicën e Veriut, kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën pretendohet se kandidati për deputet me numër rendor 29 Marko Arsiç nga Graçanica, në emër të subjektit politik Lista Serbe, më 05.02.2025, sulmoi drejtpërdrejt stendën e fushatës së PKS-së, në Graçanicë në rrugën Car Lazari, e cila ishte e regjistruar dhe e shënuar qartë, dhe tre kandidatët tanë për deputetë, shkatërroi materialin tonë të fushatës. Ky sulm fizik është raportuar edhe në Policinë e Kosovës, e cila ka hapur një hetim. Kërkojnë ta përjashtojnë këtë person nga zgjedhjet e ardhshme dhe t'i revokoni të drejtën për të mbetur kandidat dhe të dënoni rëndë Listën Serbe, sepse bëhet fjalë për një person që është kandidat në zgjedhje. Më tutje theksojnë se me këtë është dëmtuar drejtpërdrejt e drejta e tyre për zhvillimin normal të fushatës zgjedhore dhe

neni 5, paragrafi 1.1., paragrafi 1.2. deri sa në aktivitetin e planifikuar për atë ditë në Graçanicë është dashur ta përfundojnë para afatit të paraparë sepse janë penguar fizikisht nga personi i lartpërmendur.

Në vazhdim kërkojnë që brenda juridiksioni dhe kompetencat e panelit, të marren masat e duhura dhe të parandalohen shkeljet e mëtejshme të rregullave zgjedhore, si dhe të sanksionohet shkelja e lartpërmendur e rregullave të kryera nga Lista Serbe.

Në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik, Lista Serbe theksojnë se Lista Serbe nuk do të japë koment zyrtar për ankesën për momentin, sepse, siç kanë thënë vetë ankuesit, policia kompetente tashmë ka ndërmarrë veprimet e duhura lidhur me këtë rast dhe ka kryer një hetim. Më tutje theksojnë se ata besojnë se është e udhës që autoritetet kompetente të vazhdojnë hetimet për të përcaktuar të gjitha faktet dhe rrethanat relevante në lidhje me shkeljen e pretenduar. Në vazhdim të përgjigjes theksojnë se, sipas ligjeve në fuqi dhe Rregullores së Zgjedhjeve, ekziston prezumimi i pafajësisë së çdo personi derisa të provohet fajësia dhe në këtë rast, duke qenë se organet kompetente tashmë po punojnë për zbardhjen e fakteve dhe rrethanave, mendojnë se është e pabazë në këtë moment nxjerrja e ndonjë konkluzioni apo ndërmarrja e ndonjë hapi të mëtejshëm deri në përfundimin e hetimeve zyrtare.

Kërkojnë që ankesa të refuzohet si e pabazuar, pasi nuk bazohet në prova të vlefshme dhe organet kompetente kanë marrë përgjegjësinë për procedimin e mëtejshëm lidhur me këtë çështje dhe të refuzohet ankesa si e pabazuar për shkak se procedura është duke u zhvilluar pranë organeve kompetente.

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se subjekti politik Partija Kosovskih Srba (PKS), ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Lista Serbe, se kandidati për deputet me numër rendor 29 Marko Arsiç nga Graçanica, në emër të subjektit politik Lista Serbe, më 05.02.2025, ka sulmuar drejtpërdrejt stendën e fushatës së PKS-së, në Graçanicë në rrugën Car Lazari, por si dëshmi nuk ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me dëmtimin e stendës të paraqitur në ankesë dhe asnjë raport policor me të cilën theksohet se është raportuar rasti në fjalë. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit Lista Serbe për të dhënë përgjigje, por i njëjti subjekt ka deklaruar se nuk do të japë koment zyrtar për ankesën për momentin, sepse, policia kompetente tashmë ka ndërmarrë veprimet e duhura lidhur me këtë rast dhe ka kryer një hetim.

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë konstatoi se ankuesi nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vetme lidhur me rastin në fjalë dhe me asnjë provë nuk mund të vërtetohet se dëmtimin e stendës e kanë bërë aktivistët e subjektit politik Lista Serbe, dhe nuk mund të vërtetohet se subjekti Lista Serbe, është përgjegjës për shkelje të nenit 34 paragrafi

1 pika 1 të LZP-së, si në vijim: *heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, plakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik.*

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

A.nr. 417/2025 më datën 09.02.2025

Kryesuesi i Panelit
Kujtim Pasun



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.